

VENDIM

Nr. 1100, datë 28.12.2015

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2016 PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

(Ndryshuar me VKM nr.302 datë 20.04.2016)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të nenit 13, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe të nenit 29, të ligjit nr. 9936/2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit të Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2016, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Miratimin e buxhetit për programin e Shërbimit të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për vitin 2016, sipas tabelave nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2016.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

Qëllimi i Politikës së Programit

Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së shërbimeve nepermjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim automatizimin e shërbimeve, përditesimin e të dhënave dixhitale të karteles dhe hartës treguese të regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme.

OBJEKTIVAT

OBJEKTIVI 1: Përmirësimi Përditesimi i të dhënave dhe Regjistrim Fillestar
OBJEKTIVI 2: Automatizimi i sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
OBJEKTIVI 3: Ndërtimi i infrastruktures së ZRPP nrm kompletimit të zrpp me pajisje elektronike, orendi, dhe rikonstruksionit të ambienteve të ZVRPP




Tabela nr. 2

Ne 000/ leke

BUXHETI 2016 I NDRYSHUAR

Pershkrimi	Buxheti 2016 i Ndryshuar	
	Te Ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Te ardhura nga Sherbimet	2,198,471	
Shpenzime personeli		746,018
Shpenzime korente		313,074
Investime		1,139,379
Fondi rezerve (2% e te ardhurave)		0
Total	2,198,471	2,198,471
Teprica (1)-(2)		0